2. Autoriteti/Enti Kontraktor përdor si kriter vlerësimi një nga kriteret e përcaktuara në Njoftimin e Kontratës.

3. Autoriteti/Enti Kontraktor do t'i japë kontratën Operatorit Ekonomik, Oferta e të cilit ka rezultuar të jetë ekonomikisht më e favorshme.

22. Korrigjimi i gabimeve aritmetike dhe ofertave anomalisht të ulëta

1. Autoriteti/Enti Kontraktor kontrollon ofertat e paraqitura nëse kanë gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike, autoriteti/enti i korrigjon këto gabime si më poshtë:

- (a) Nëse ka ndonjë mospërputhje midis çmimit për njësi dhe çmimit total, që rezulton nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.
- (b) Nëse ka ndonjë mospërputhje tek çmimi total, kur totali është shuma ose diferenca e nëntotaleve, çmimi i nëntotalit mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.
- (c) Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet shumës në fjalë dhe shumës në shifra, mbizotëron shuma në fjalë. Bën përjashtim nga ky rregull situata kur, shuma në fjalë ka mospërputhje me shumën në shifra, ndërkohë që kjo e fundit nuk ka gabime aritmetike në përlllogaritjen e zërave të ofertës.

Në çdo rast, Ofertat me gabime aritmetike refuzohen kur:

- shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;
- shuma absolute e të gjitha korrigjimeve është më pak se 2%, por nuk pranohet korrigjimi nga ofertuesi.

2. Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% të fondit limit të përlogaritur.

Në rast kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve.

Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet ti kërkojë operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe të vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin, në përputhje me dispozitat e këtij neni.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin/elementët specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O - Oferta

MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme

N - Numri i ofertave të vlefshme

PR (Zm) – Zbritje e mundshme

$$MO = O1 + O2 + O3 + \dots On / N$$

$$PR = 85 \% Mo$$

Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët.

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin/Entin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

D. DHËNIA E KONTRATËS

23. Njoftimi i Fituesit

1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës

1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.

2. Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor;
- b) garanci bankare
- c) garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT

25. Procedura e ankesës

1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen

ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.

2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;
 - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
 - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
 - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose

entit kontraktor ka ndryshuar;

e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.
4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës [Ekonomike](#)

Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 8: Formulari i Termave të Referencës

Shtojca 9: Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit.

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimit.

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi -të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontratës;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**
_____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës Ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>5</i>	
Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

(⁶Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

⁶ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

DEKLARATË

Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik “.....” për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objektështë i pamiratuar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

Shtojca 6.

[*Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor*]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të

hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Specifikime teknike dhe metodologjia

1. Shërbime në sipërfaqet e luleve te fushes (sezonale).

Punimet kryesore për mirmbajtjen e luleve sezonale jane:

- Punim toke+pregatitje per mbjellje. (gjithe procesi per mbjellje te luleve)
- Mbjellje lule sezonale me kunje
- Capitje lule sezonale
- Plehrim i siperfaqeve te luleve sezonale realizohet duke shperndare plehun ne ndarjet e luleve dhe menjehere pas kesaj sperkasim siperfaqen e luleve me qellim qe te permbyset nitrati ne toke dhe me pas te ujitet siperfaqja.
- Disifektim i siperfaqeve te luleve me preparat kimik (semundje)
- Ujitje e siperfaqeve te luleve
- Luftimi i semundjeve (sperkatje):

Është një proces që kryhet gjatë muajve maj-qershor dhe ka për qëllim luftimin e sëmundjeve dhe dëmtuesve.

Mbjellja e luleve është parashikuar në dy zezone, llojet e luleve që do të përdoren janë Violat, Ciklamina, Taget, Petuniat etj

2. Mirëmbajtja e barit të kultivuar:

Punimet kryesore për mirëmbajtjen e tapetit të barit janë:

- Pastrim i sipërfaqes së barit nga papastërtite.
- Krehja e sipërfaqes së barit, do të kryhet me një frekuencë 20 herë në vit duke larguar çdo mbetje gjethesh, degesh dhe mbetje nga kositja, me krëhër metalik
- Plehrim i tapetit të barit 4 herë në vit. Ky proces pune kryhet zakonisht pas kositjes së sipërfaqes së barit kryesisht gjatë muajve prill, maj, shtator, nëntor. Produktet plehruese duhet të jenë me shkërrje të ngadalte me përmbajtje azoti, fosfori dhe kaliumi për të përmbushur sa më mirë nevojat agroteknike të tapetit të barit.
- Kositja e sipërfaqes së barit 20 herë në vit me makina korrëse në 90 % të sipërfaqes dhe në 10% me kosa motorrike aty ku është e pamundur të kryhet me makina korrëse.
- Vaditja e tapetit të barit me frekuencë 130 herë në vit.

Vaditja e barit gjatë periudhës së verës, që do të realizohet nëpërmjet tubave të gomës dhe në vendet ku nuk ka rrjet uji do të kryhet me bote. Duke përdorur 5 l ujë për meter katror.

Kontraktori duhet të kryejë rinovimin e një sipërfaqe prej 20% në vit, sipas kërkesës dhe përcaktimit të Autoritetit Kontraktor.

Shërbimi i rinovimit të hapësirave të gjelberta publike konsiston në:

- Punimi i parë tokës në një thellesi 35-40 cm.
- Shkërrimi dhe thyerje plisash duke bërë pastrimin e gurëve, rrenjëve dhe çdo papastërtie tjetër.
- Sheshim i dheut.
- Punim i dytë 20 cm thellesi duke mbuluar plehun.
- Krehje dhe nivelim.
- Mbjellje e farës së barit.
- Rrullim dhe ngjeshje pas mbjelljes.

3. Mirëmbajtja e barit natyral:

Punimet kryesore për mirëmbajtjen e barit natyral:

- Pastrim i sipërfaqes së barit nga papastërtite.
- Krehja e sipërfaqes së barit, do të kryhet me një frekuencë 12 herë në vit duke larguar çdo mbetje gjethesh, degesh dhe mbetje nga kositja, me krëhër metalik,
- Plehrim i tapetit të barit 2 herë në vit. Ky proces pune kryhet zakonisht pas kositjes së

sipërfaqes së barit kryesisht gjatë muajve prill, nëntor.

Produktet plehruese duhet të jenë me shkirje të ngadalte me permbajtje azoti, fosfori dhe kaliumi për të përmbushur sa më mirë nevojat agroteknike të tapetit të barit.

- Kositja e sipërfaqes së barit 12 herë në vit me makina korrëse në 90 % të sipërfaqes dhe në 10% me kosa motorrike aty ku është e pamundur të kryhet me makina korrëse.
- Vadija e tapetit të barit me frekuencë 80 herë në vit.

Vadija e barit gjatë periudhës së verës, që do të realizohet nëpërmjet tubave të gomës dhe në vendet ku nuk ka rrjet uji do të kryhet me bote. Duke përdorur 5 l ujë për meter katror.

4. Mirëmbajtja e stolave dhe pastrimi i rrugëve dhe terreneve brenda parqeve.

Pastrim i të gjithë sipërfaqes të asfaltuar dhe/ose të këmbësorëve brenda zonës së gjelbëruar ose terreneve brenda parkut duke iu referuar çdo lloj mirëmbajtjeje që përfshin grumbullimin dhe transportimin e çdo lloj mbetjeje të ngurtë (letër, qelq, plastikë, bimësi dhe gjethe të herëpashershme, etj.).

I. Mirëmbajtja e stolave dekorativë

Në pjesën më të madhe të sipërfaqeve të gjelbra, krahas elementëve të tjerë janë vendosur stola dekorativë për relaksim dhe qytetarëve dhe do të bëhet mirëmbajtja e tyre. Këto stola janë të ndërtuara me konstrukcion metalik dhe me ndenjëse dhe mbështetëse druri, Vlerësohet se ato duhet të riparohen çdo vit.

Riparimet përbëhen nga elementë metalik dhe druri pasi dëmtohen në kushte të këqija moti, struktura e dërrasës ka nevojë për riparime dhe lyerje me bojë vaji. Gjatë gjithë vitit do të mirëmbahen 216 stola dekorativë

II. Mirëmbajtja e drurëve dekorativë

Procesi përfshin të gjitha ndërhyrjet e krasitjes që do të kryhen për një dru apo pemë të shëndetshme por edhe për nevojat e aksesueshmërisë, trafikut dhe sigurisë (dukshmëri për pasagjerët, tabela, etj)

Shërbimet kryesore në këto drurët dekorativë do të jenë:

- Krasitje e drurëve dekorativë gjethe mbajtës (proces që do të kryhet 2 herë në vit për mbajtjen e tyre në formë të përshtatshme dekorative)
- Krasitje të drurëve gjethërenes + palmat

Procesi përfshin të gjitha ndërhyrjet e krasitjes e cila kryhet në periudhën dhjetor – shkurt, periudhë në të cilën pemët janë në qetësi relative.

- Pleherim

- Vadtje, ky proces duhet të kryhet duke respektuar standartin e harxhimit të 30-50 litër ujë për shkurret dhe drurët dekorative.
- Luftim semundje, është një proces që kryhet gjatë muajve maj-qershor dhe ka për qëllim luftimin e sëmundjeve dhe dëmtuesve për të luftuar insektet e ndryshme për të ruajtur vegjetacionin dekorativ.

5. Mirëmbajtja e shkurreve dekorative

- Punim i shkurreve ky proces ka si qëllim punimin rreth tyre për të eliminuar barërat e këqija dhe shkrihimin e tokës
- Krasitje e shkurreve dekorative, do të kryhet 4 herë në vit duke i dhënë formën e duhur dekorative.
- Pleherim
- Vadtje ky proces duhet të kryhet me bot duke respektuar standartin e harxhimit të 30-litër ujë për shkurre.
- Luftim semundje është një proces që kryhet gjatë muajve maj-qershor dhe ka për qëllim luftimin e sëmundjeve dhe dëmtuesve për të luftuar insektet e ndryshme për të ruajtur vegjetacionin dekorativ.

6. Mirëmbajtja e bordurave të gjelbra

- Punim i shkurreve ky proces ka si qëllim punimin rreth tyre për të eliminuar barërat e këqija dhe shkrihimin e tokës
- Krasitje e bordurave, do të kryhet 8 herë në vit duke i dhënë formën e duhur dekorative.
- Pleherim
- Vadtje ky proces duhet të kryhet me bot duke respektuar standartin e harxhimit të 30-litër ujë për shkurre.
- Luftim semundje është një proces që kryhet gjatë muajve maj-qershor dhe ka për qëllim luftimin e sëmundjeve dhe dëmtuesve për të luftuar insektet e ndryshme për të ruajtur vegjetacionin dekorativ.

Rregulla për tu zbatuar

1. Struktura e ngarkuar për zbatimin e kontrates ka të drejtë të kontrollojë në çdo kohë si gjatë kryerjes së shërbimit dhe pas përfundimit të tij nga Kontraktori.
2. Shërbimi i pastrimit me punëtorë me fshesa të përshtatëshme do të kryhet në të gjithë sipërfaqen e lulishteve duke larguar çdo mbetje dhe papastërti me një frekuencë 2 herë në muaj.
3. Produktet plehruese duhet të jenë me shkrirje të ngadalte me përmbajtje azoti, fosfori dhe kaliumi për të përmbushur sa më mirë nevojat agroteknike të tapetit të barit dhe do të bëhet 4 herë në vit në të gjithë sipërfaqen.
4. Produktet plehruese duhet të jenë të regjistruara dhe të lejuara sipas legjislacionit në fuqi, do të ndalohet përdorimi i produkteve plehruese të paregjistruara; produkteve plehruese me përmbajtje substancash të dëmshme, të cilat mund të përbëjnë rrezik për sigurinë ose shëndetin e njerëzve, kafshëve ose bimëve, ose një rrezik për mjedisin.
5. Kontraktori do të nxitet të implementojë “Praktikat e mira të mbrojtjes së bimëve” ku tërësia e masave dhe e veprimeve për kontrollin e parazitëve me metodat kimike, duke

respektuar kushtet në të cilat PMB-të janë regjistruar, si: respektimi i kufijve kritikë, zgjedhja e dozës dhe volumit, koha dhe numri i trajtimeve, mbrojtja e entomofaunës natyrale dhe mjedisit, si dhe kujdesi për shëndetin e përdoruesve e tëkonsumatorëve.

6. Trajtimet me PMB duhet të kryhen me mjete dhe makineri sipas legjislacionit në fuqi për makineritë, që përfshin dhe makineritë për përdorim të PMB-ve, për të garantuar sigurinë e shëndetit të përdoruesve, të mjedisit dhe të bimëve.

7. Kontraktori duhet të kryejë grumbullimin dhe transportimin e të gjitha mbetjeve që rezultojnë nga pastrimi, kositja dhe krasitja në vende të miratuara për depozitim.

8. Për grumbullimin dhe ngarkimin e mbetjeve, do të përdoren kamionçina vetshkarkuese me mbulesa të posaçme për mos lejuar derdhjen e mbetjeve.

2. SHERBIMI I MIREMBAJTJES TE VARREZAVE NE QYTETIN E LEZHES.

Sherbimi qe kerkohet :

-Mirembajtje te sipërfaqeve te luleve ne varreza. (pleherim ,vadtje etj)

-Mirembajtje ne sipërfaqet e barit te kultivuar ne varreza (kositje, vadtje, pastrime, krehje).

-Punime me bel (I-re dhe II-te) ne sipërfaqe te barit te kultivuar sipërfaqet e luleve dhe bimesise dekorative shkurre.

-Pastrim dhe kositje e sipërfaqeve te barit natyral dhe te kultivuar.

-Krasitje e bimesise dekorative shkurre.

-Pleherim dhe vadtje bari dhe bimesise dekorative.

-Pastrim dhe mirembajtje e sipërfaqeve inerte, rruge e sheshe, sipërfaqe me varre dhe sipërfaqe te lira per varre.

-Mirembajtje e bordurave, ndertesave, rrethimit te varrezave publike dhe deshmoreve etj.

Sherbimi do te realizohet ne te gjitha sipërfaqet e varrezave publike ne “Gryke Zeze” dhe varrezat publike ne “Gocaj”, si dhe ne varrezat e “Deshmoreve” mbeshtetur ne inventarin e elementeve bimore dhe ndertimore qe administrohen nga Bashkia Lezhe.

Nr	Emertimi	Pershkrimi i sherbimit
a.	- Mbjellje dhe sherbime ne sipërfaqe te barit te kultivuar	
1-	Punim i pare me bel.	Me kete sherbim toka punohet ne thellesi 20-25cm. Ky punim kryhet duke e permbysur plisin dhe nxjerre nga toka te gjithë barerat e keqia, plisi pritët ne disa pjese duke krijuar nje mjedis pjesisht te rrafshet .
2-	Punimi i dyte me bel.	Ky punim kryhet ne thellesi 20 cm duke e permbysur plotesisht dheun qe del nga ky punim.Me kete sherbim largohen te gjitha mbeturinat e ndryeshme inerte , bimore ,si dhe barerat e pa kalbura. Gjate ketij punimi toka nivelohet mire .
3-	Shperndarje superfosfati .	Ky process realizohet pas punimit te dyte te tokes,para sistemimit me shate. Superfosfati hidhet me dore dhe ne menyre uniforme net e gjithë sipërfaqen e punuar dhe mbulohet gjate sistemimit me shate.
4-	Sistemim me shate.	Gjate ketij procesi thuhën plisat me diameter te madh, behet shkruftimi i dherave dhe nxjerrja e barerave te keqia te mbuluara nga punimi i dyte. Ky sherbim kryhet ne thellesi 10 cm. Ne perfundim te tij procesi krijohet shtrati per hedhjen e fares se barit.
5-	Hedhja e fares barit.	Pas kryerjes se te gjitha proceseve te punes te cilat kane te bejne me pregatitjen e tokes per mbjellje hidhet fara e barit, process pune qe kryhet me krah.
6-	Mbulimi i fares barit.	Ky sherbim i cili synon mbulimin e fares se barit me dhe eshte nje process pune qe kryhet me krah dhe krijon mundesine e krijimit te kushteve te pershtatshe per mbirjen e faras. Sasia e dheut qe mbulon faren nuk duhet ti kaloje 2 cm, ne te kundert mbirja veshtiresohet dhe rrezikon kalbezimin e fares .

7-	Rulimi dhe ngjeshja e tokes	Rulimi i tokes behet uniforme duke perdorur nje peshe te pershtateshme per kete qellim ne menyre qe te mos te ngjeshe shume token per te penguar mbirjen.
8-	Vaditja e siperfaqes se barit.	Ky process kryhet ne te gjitha rastet kur thatesira veshtireson zhvillimin e embrionit te fares, per kete aresye kryhet nje vaditje e lehte ne forme shiu .
9-	Nitrifikimi	Nitrifikimi i siperfaqeve te mbjella me bare kryhet me dore te lire ne te gjitha siperfaqen ne menyre te njetrajteshme, kujdes i vecante duhet treguar ne ne zonat e barit ku ngjyra e barit eshte e zbehte .
10-	Krehja e siperfaqeve te barit.	Ky process kryhet per te mbajtur te paster siperfaqen e barit dhe per te krijuar kushte te pershtateshme per rritjen dhe zhvillimin e barit.Eshte nje process qe ndihmon ne rritjen e fuqise se bimes per vllazerim.
11-	Pastrimi i siperfaqeve te barit.	Ky eshte nje proces pune i cili kryhet cdo dite per te krijuar tapete te pasterta nga mbeturinat e ndryeshme .
12-	Heqja e barerave te keqia me bajonete.	Ky process kryhet sa here konstatohen barera te keqia ne siperfaqen e tapetit, por duhet kryer me shune kujdes per te mos demtuar barin e mbjelle dhe moskrijimin e vatrave te lira nga bari.
13-	Kositja.	Kositja behet me makine kositese bari, cdo 20-25 dite kryesisht ne periudhen e pranveres dhe veres kur rritja e barit eshte ne menyre intensive.Kositja duhet bere me rrjeshta te drejte duke krijuar nje sfond te rregullt te tapetit te barit.
b. <i>Sherbime ne siperfaqe te barit natyral</i>		
1-	Pastrimi dhe largimi i mbeturinave me krah dhe mjete te mekanizuara.	Nje nga proceset e punes per mirembajtjen e barit natyral eshte edhe pastrimi nga mbetjet e ndryeshme bimore, urbane, inerte etj. Ky sherbim eshte i perditeshem dhe kryhet me dore ose me rreshqel. Mbeturinat e grumbulluara largohen me mjete te ndryshme si korroca dhe mjete transporti ne pikat e grumbullimit te percaktuara per kete qellim. Me kete duhet te kuptojme se ne siperfaqet e barit natyral vazhdimisht krijohen mbeturina inerte nga hapja dhe mbyllja e varreve.
2-	Kositja e barit.	Kositja e barit kryhet me motorrkorrese cdo 20-25 dite sidomos gjate periudhes se pranveres dhe veres dhe grumbullohet ne nje cep per tu transportuar, pas kositjes kryhet krehja e barit per te ktijuar nje tapet te paster dhe te sistemuar
c. <i>Sherbime ne shkurre dekorative</i>		
1-	Punim i pare	Ky punim behet me bel ,ne thellesi 20-25 cm nga muaj dhjetor . Ky punim ka per qellim te permbysh plisin e dala nga vera i cili eshte i ngjeshur dhe i mbushur me infeksione dhe barer ate keqia .
2-	Punimi i dyte	Punimi i dyte me bel realizohet ne fillimet e pranveres pasi mjedisi i punuar me bel ka qendruar i fjetur per dy-tre muaj. Ky punim ka per qellim nxjerrjen e barerave te keqia si dhe sistemimin e tokes rreth bimes .
3-	Prashitje e pare	Ky sherbim behet pas punimit te dyte te tokes dhe ka per qellim sistemimin e tokes dhe mbylljen e hapesirave te krijuara nga punimi i dyte si dhe krijimin e porozitetit (kapilaritetit) te nevojshem per kryerjen e proceseve fiziologjike te sistemit rrenjore .
4-	Prashitja e dyte	Prashitja e dyte ka si objekt me shume prerjen e barerave te keqija per mbrojtjen e kapilaritetit te tokes, mbrojtjen e bimes nga thatesira dhe krijimin e nje mjedisi te kulturuar. Ky process kryhet nga fundi pranveres para fillimit te temperaturave te larta te veres.
5-	Krasitja e shkurreve dekorative .	Krasitja e shkurreve dekorative behet me kujdes nga nje specialist i kualifikuar ,ky sherbim kryhet ne periudhen e vjeshtes dhe te dimrit. Ky sherbim ka si qellim heqjen e degeve te teperta si dhe ato te thara duke krijuar nje kurore te pershtateshme .krasitja behet gjithnje ne kohe te mire, pa lageshtire dhe ngrica dhe orari me i pershtateshem eshte nga ora 10:00-14:00.
6-	Krasitje formuese	Krasitja formuese realizohet ne menyre periodike cdo 20 - 25 dite, duke filluar nga muaj maji e ne vazhdim. Ky sherbim ka si qellim krijimin e kurores dekorative, duke i dhene asaj formen e parashikuar ne mozaikun e bimeve te mjedisit te gjelbert.
7-	Vaditja	Ky process realizohet kryesisht gjate periudhes se muajve te veres dhe vaditja behet kryesisht ne forme shiu .Vaditja rekomandohet te kryhet ne oret e para te mengjesit dhe pasdite vone por jo ne pikun e temperatuarve te larta te dites.
d. <i>Mbjellja dhe sherbimet ne siperfaqet e luleve</i>		

1-	Punimi i pare	Me kete sherbim toka punohet ne thellesi 20 -25cm.Ky punim kryhet duke e permbysur plisin dhe nxjerre nga toka te gjitha barerat e keqia, plisi pritët ne disa pjese duke krijuar nje mjedis pjesisht te rrafshet
2-	Punimi i dyte	Ky punim kryhet ne thellesi 20 cm duke e permbysur plotesisht dheun qe del nga ky punim.Me kete sherbim largohen te gjitha mbeturinat e ndryeshme inerte, bimore si dhe barerat e pa kalbura. Gjate ketij punimi toka nivelohet mire.
3-	Hedhje superfosfati	Ky process realizohet pas punimit te dyte te tokes, para sistemimit me shate. Superfosfati hidhet me dore dhe ne menyre uniforme net e gjithë sipërfaqen e punuar dhe mbulohet gjate sistemimit me shate.
4-	Nivelim	Gjate ketij procesi thuhet plisat me diameter te madh, behet shkriftimi i dherave dhe nxjerrja e barerave te keqia te mbuluara nga punimi i dyte. Ky sherbim kryhet ne thellesi 10 cm. Ne perfundim te tij procesi krijohet shtrati per hedhjen e fares.
5-	Mbjellja	Pas kryerjes se te gjitha proceseve te punes te cilat kane te bejne me pregatitjen e tokes per mbjellje hidhet fara, process pune qe kryhet me krah.
6-	Pleherim	Pleherimi i sipërfaqeve te mbjella me lule kryhet me dore te lire ne te gjithë sipërfaqen ne menyre te njetrajteshme.
7-	Vaditje	Ky proces kryhet ne te gjitha rastet kur thatesira veshtireson zhvillimin e embrionit te fares, per kete arsye kryhet nje vaditje e lehte ne forme shiu pas mbjelljes dhe pastaj sa here eshte e nevojshme.
e. <i>Sherbime ne drure dekorative</i>		
1-	Punim me bel	Ky punim behet me bel ,ne thellesi 20-25 cm nga muaj dhjetor . Ky punim ka per qellim te permbys plisin e dala nga vera i cili eshte i ngjeshur dhe i mbushur me infeksione dhe barer ate keqia .
2-	Krasitje	Krasitja e drureve decorative behet me kujdes nga nje specialist i kualifikuar ,ky sherbim kryhet ne periudhen e dimrit. Ky sherbim ka si qellim heqjen e degeve te teperta si dhe ato te thara duke krijuar nje kurore te pershtateshme .krasitja behet gjithnje ne kohe temire ,pa lageshtire dhe ngrica .
3-	Pleherim	Pleherimi behet kryesisht ne periudhen e pranveres me nitrat pasi te jete bere me pare punimi me bel .
4-	Vaditja	Vaditja behet gjate periudhes se veres kur si rezultat i temperaturave te larta ndjehet mungesa e lageshtires, vaditja zakonisht kryhet me tub gome .
f. <i>Sherbimet ne gardhet e gjelberta</i>		
1-	Punimi me bel	Ky punim behet me bel ,ne thellesi deri ne 20 cm ne pranvere dhe ne vjeshte . Ky punim ka per qellim te permbys plisin cili eshte i ngjeshur dhe i mbushur me infeksione dhe barer ate keqia .
2-	Krasitje	Krasitja e gardheve te gjelberta behet me kujdes nga nje specialist i kualifikuar ,ky sherbim kryhet disa here gjate vitit kryesisht gjate periudhes se vegetacionit te bimeve dhe ka si qellim dhenjen e formes se duhur ketyre gardheve te gjelberta .
3-	Pleherim	Pleherimi i sipërfaqeve te gardheve te gjelberta kryhet me dore te lire ne te gjithë sipërfaqen ne menyre te njetrajteshme dy here gjate vitit .
4-	Vaditje	Vaditja behet gjate periudhes se veres kur si rezultat i temperaturave te larta ndjehet mungesa e lageshtires ,vaditja zakonisht kryhet me tub gome .
g. <i>Sherbime ne sipërfaqe inerte dhe rruge e sheshe si dhe sipërfaqe me varreza dhe te lire per varre</i>		
1-	Pastrimi i sipërfaqeve	Ky sherbim behet per pastrimin e sipërfaqeve inerte nga mbeturinat e ndryeshme urbane, inerte, bimore, etj...
2-	Mirmbajtja e bordurave dhe varreve prej mermeri	Pastrimi i sipërfaqeve me uje behet disa here gjate vitit ne menyre qe keto objekte te jene vazhdimisht ne gjendje te mire.
3-	Mirmbajtje e ndertesave te sherbimit dhe rrethimi i varrezave	Mirmbajtja e ambjenteve te ndertesave si tek varrezat publike ashtu edhe te deshmoreve duhet te jete ne nivelin e prezantimit me culture ne syrin e qytetareve qe vijne ne keto objekte. Lyerja e ndertesave, merimetimi i tyre, dyer dhe dritare si dhe elemente te tjere ndertimi te kihet parasysh sebashku me mirmbajtjen e rrethimit dhe lyerjen me boje te tyre minimalisht dy here ne vit.

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet:**1. Sherbimi i mirembajtjes te sipërfaqeve të gjebërta**

Nr.	Emertimi	Njesia	Sasia
1	Sherbime sipërfaqes luleve te fushes	m ²	662
2	Sherbime sipërfaqes te barit te kultivuar	m ²	11,477
3	Sherbime sipërfaqes barit natyral	m ²	42,120
4	Sherbime ne sipërfaqe inerte dhe stola	m ²	35,997
5	Sherbime ne druret decorative	Cope	2,549
6	Sherbime ne shkurret decorative	Cope	2,307
7	Sherbime ne bordurat e gjelberuara	ml	5,683

2. Sherbimi i mirembajtjes te varrezave ne qytetin e Lezhes

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia
1	Sherbime sipërfaqes luleve te fushes, mbjellje 2 here ne vit.	m ²	200
2	Sherbime sipërfaqes se bari te kultivuar.	m ²	424
3	Sherbime sipërfaqes barit natyral	m ²	5,000
4	Pastrim dhe mirembajtje varresh	m ²	3,200
5	Sherbime ne druret dekorative	Cope	150
6	Sherbime ne shkurret dekorative	Cope	220
7	Sherbime ne bordura te gjelberuara	ml	160

Afatet e ekzekutimit: 12 Muaj nga data e nenshkrimit te kontrates.

Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

Detyrat:

Shpërndarja:

Vendi i kryerjes së shërbimeve:

TERMA REFERENCE

1. SHËRBIMI I MIREMBAJTJES TE SIPËRFAQEVE TË GJELBËRTA

Qëllimi: Qasje strategjike dhe të qëndrueshme për menaxhimin e hapësirave të gjelbërta.

Objektivat:

- Menaxhimi efikas i gjelbërimit urban në Bashkinë e Lezhës nepermjet kontraktimit me sipermarrje private.
- Te ofrojë mundësi dhe kënaqësi për qytetarët për një jetë të shëndetshme duke përdorur në mënyrë të kontrolluar dhe të mençur hapësirat e gjelbërta.
- Te përmirësojë pejzazhet e gjelbërta urbane në Bashkinë e Lezhës.


Rëndësia e gjelbërimit.

Gjelbërimit dhe shëndeti: Menaxhimi, organizimi dhe mirëmbajtja e hapësirave të gjelbërta është i rëndësishëm për: shëndetin e qytetarëve, paraqitje dinjitoze, ruajtjen e tokës dhe dheut nga erozioni apo shpëlarjet që mund të vijnë nga shirat e rrëmbyshëm, ruajtjen dhe mbajtjen e ujërave në sistemin rrënjor të pemëve, shkurreve dhe barit. Përherë edhe më shumë me zhvillimet e fundit, referuar edhe situatës që kaluam nga pandemia COVID 19, hapësirat e gjelbëra janë vendi që ndihmon dhe lehtëson qytetarët për të kaluar ditët gjatë dhe pas situatave pandemike.

Gjelbërimit dhe sporti: Qasja dhe ofrimi i hapësirave të gjelbëra në shërbim të qytetarëve dhe komuniteteve të caktuara do të ndihmojë në realizimin e sporteve të lehta apo edhe organizimin e eventeve të ndryshme.

Gjelbërimit dhe turizmi: Lezha është një ndër vendet e rëndësishme të turizmit në Shqipëri, ku turistët përveç palzhit të Shëngjinit frekuentojnë edhe mjediset e qytetit, duke njohur kulturën dhe historinë e tij, andaj ofrimi i gjelbërimit sipas standardeve do ta prezantonte denjësisht qytetin tek turistët vendas dhe ata të huaj.

Vende pune: Për të realizuar gjelbërimitin e qytetit nevojiten jo vetëm punonjës për realizimin dhe mirëmbajtjen e shërbimit por njëkohësisht edhe bashkëpunohet me kompani të cilat ofrojnë pemët apo shkurret që përdoren për rekreacionin e qytetit. Cikli i gjelbërimit është një cikël i cili përfshin disa aktorë në vetvete.



Çfarë dhe si?

Shërbimi i gjelbërimit në Bashkinë e Lezhës do të kryhet në qytetin e Lezhës dhe Njesinë Administrative të Shengjinit si më poshtë:

Zona nr. 1: Sipërfaqja e gjelbërimit të lagjes “Skënderbeg”,

Zona nr. 2: Sipërfaqja e gjelbërimit të Parkut Qendror-Lulishtja përballë Memorialit të Skenderbeut,

Zona nr. 3: Sipërfaqja e gjelbërimit Qendra e qyteti,

Zona nr. 4: Sipërfaqja e gjelbërimit “Shetitorja e Lumit Drin”, në qytetin e Lezhës, në të dy anët,

Zona nr. 5: Sipërfaqja e gjelbërimit në Lagjen “Beslidhja”,

Zona nr. 6: Sipërfaqja e gjelbërimit Rruga e Lalmit të ri,

Zona nr. 7: Sipërfaqja e gjelbërimit blloku i Turizmit - Lulishtja 11 janari, pranë Bulevardit “Gjergj Fishta”,

Zona nr. 8: Sipërfaqja e gjelbërimit blloku i banimit në Bulevardin “Luigj Gurakuqi” rreth Xhamisë së Lezhës,

Zona nr. 9: Sipërfaqja e gjelbërimit lulishtja përballë gjimnazit Hydajet Lezha,

Zona nr. 10: Sipërfaqja e gjelbërimit rruga “Kosova” – Rruga “Faik Konica” Kufizimi i Lagjes Gurra,

Zona nr. 11: Sipërfaqja e gjelbërimit Bulevardi “Gjergj Fishta”, dy anët deri tek “Varrezat e Dëshmorëve”,

Zona nr.12: Sipërfaqja e gjelbërimit blloku i banimit në Lagjen “Gurra”,

Zona nr.13: Gjelbërimi rrugor i qytetit,

Zona nr. 14: Sipërfaqja e gjelbërimit në Parkun “Dua të Luaj”.

Zona nr. 15: Sipërfaqja e gjelbërimit në mjediset e shkollave të Mesme,

Zona nr. 16: Sipërfaqja e gjelbërimit në mjedisin e shkollës “Gjergj Fishta”

Zona nr .17: Sipërfaqja e gjelbërimit në mjediset e shkolles “Gjergj Kastrioti”

Zona nr. 18: Sipërfaqja e gjelbërimit në mjediset e shkollës “Nënë Tereza”

Zona nr. 19: Sipërfaqja e gjelbërimit në Njesinë Administrative Shengjin,

Ndërsa në zonat e tjera në Njesitë Administrative të Bashkisë Lezhë shërbimi i gjelbërimit do të mirembahet nga punonjësit e Njesive Administrative.



Siperfaqet e gjelberimit ne qytetin e Lezhes:




Siperfaqet e gjelberimit ne Njesine Administrative ne Shengjin:



Plani i veprimet të gjelbërimit.

Janë veprimet e marra që do të mundësojnë përmbushjen e qëllimit të këtyre objektivave të planit të menaxhimit të gjelbërimit të qytetit.

- 1 Plani për ruajtjen e gjelbërimit ekzistues dhe shtimin e tij në të ardhmen,
- 2 Ofrim në mënyrë të kënaqshëm për shërbimin e gjelbërimit për qytetarët dhe turistët e qytetit.
- 3 Te Ofrorë sipërfaqet e gjelbërta sipas nevojave dhe rekomandimeve të përdoruesve të hapësirave të gjelbëra.



Planifikimi i Kostos të Shërbimit të Gjelbrimit.

Për vetë specifikën dhe shumëllojshmërinë e punimeve që do të mbulohen në hartimin e kostove teorike u analizuan dhe kalkuluan në detaje çdo proces pune dhe shpenzimet materiale

të domosdoshme për realizimin e tyre. Në llogaritjen e kostove teorike u mbajten parasysh disa kritere si:

-Percaktimi i normave të punës mbështetur në librin e normave për sektorin e gjelberimit të vitit 1989.

-Planifikimin e materialeve,veglave të punës dhe shpenzimeve të ndryshme.

-Të gjitha studimet që janë berë mbi ecurinë dhe perspektivën e gjelberimit në vitet në vazhdim u përfshinë në përlogaritjen e kostos teorike sidomos për sa i përket mundësisë së motorizimit të proceseve të punës gjë që ndikon direkt në uljen e kostos së mirëmbajtjes por edhe të zvogelimit të numrit të fuqisë punëtore.

Mbështetur në sa thamë më lart edhe për një llogaritje sa më saktë të kostos, u bë kategorizimi i objekteve të gjelberimit duke u bazuar në natyrën e punës, sasinë dhe cilësinë e punimeve, periodicitetin e kryerjes së tyre, si dhe sasinë e domosdoshme të përdorimit të materialeve që kërkohet për mirëmbajtjen optimale të objekteve. Më poshtë po japim disa sqarime mbi kategorizimin e objekteve.

Hapësirat e gjelbëra sipas kategorive.

Hapësirat e gjelbërta janë në shërbim të qytetarëve dhe i shërbejnë rekreacionit të qytetit. Në tërësinë e tij gjelbërimi i qytetit ndahet sipas kategorive:

Kategoria 1: Përfshin të gjitha ato objekte që shtrihen në qendër të qytetit, kanë një strukturë të mirëfilltë lulishteje dhe sasia e cilësia e punimeve kërkohet në shkallën më të lartë. Përmban lule dhe bar të kultivuar, drurë dekorativ dhe shkurre të cilat së bashku i përshtaten më së miri kushteve morfologjike të tokës (dheut) dhe kushteve klimaterike të Lezhës (bli, manjola, ullinjë, bredha, palma, pisha etj).

Kategoria 2: Kjo kategori me struktura e bimesise (drure, shkurre e lule) dhe fluksi i madh i vizitoreve janë të përafërta me ato të një lulishteje, prandaj kjo zonë kërkon një seri punimesh mirëmbajtëse të domosdoshme për mbajtjen e saj. Si rezultat kërkohet një volum më i vogël punimesh mirëmbajtëse.

Gjelberimi rrugor

Përfshin mirëmbajtjen dhe shërbimet ndaj drureve të mbjelle në rrugët e qytetit ku sipas natyrës së punës e kemi ndare:

-Mirëmbajtje dhe shërbime në drurët e mbjelle në rrugë duke filluar nga viti i parë i mbjelljes e deri në vitin e fundit para prerjes dhe duke qenë se lloji dhe sasia e shërbimeve ndryshon nga viti në vit kostot u llogariten në disa kategori si më poshtë:

-Kosto e mirëmbajtjes së drureve nga viti i II deri në vitin e IV .

-Kosto e mirëmbajtjes së drureve nga viti V deri në vitin e X mbas mbjelljes.

Identifikimi dhe përshkrimi i shërbimit.

Duke qenë se në qytetin e Lezhës pothuajse në të gjitha hapësirat e gjelbra gjenden të gjithë elementët (si dru dekorativ, shkurre dekorative, gardhe të gjelberta, bar natyral, lule dhe stola dekorativë) dhe në planifikimin e këti shërbimi janë trajtuar të gjithë këta elementë.

Në këtë plan janë identifikuar paraprakisht të gjitha hapësirat e gjelbra, druret, shkurret dekorative aktuale si dhe hapësirat për mbjelljen me lule sezonale.

Specifikime teknike dhe metodologjia

5. Shërbime në sipërfaqet e luleve të fushës (sezonale).

Punimet kryesore për mirëmbajtjen e luleve sezonale janë:

- Punim tokë+pregatitje për mbjellje. (gjithë procesi për mbjellje të luleve)
- Mbjetllje lule sezonale me kunjë
- Capitje lule sezonale
- Plehrim i sipërfaqeve të luleve sezonale realizohet duke shpërndarë plehun në ndarjet e luleve dhe menjëherë pas kësaj spërkasim sipërfaqen e luleve me qëllim që të përmbysset nitrati në tokë dhe më pas të ujitet sipërfaqja.
- Disifektim i sipërfaqeve të luleve me preparat kimik (semundje)
- Ujitje e sipërfaqeve të luleve
- Luftimi i sëmundjeve (spërkatje):

Është një proces që kryhet gjatë muajve maj-qershor dhe ka për qëllim luftimin e sëmundjeve dhe dëmtuesve.

Mbjellja e luleve është parashikuar në dy zezone, llojet e luleve që do të përdoren janë Violat, Ciklamina, Taget, Petuniat etj

6. Mirëmbajtja e barit të kultivuar:

Punimet kryesore për mirëmbajtjen e tapetit të barit janë:

- Pastrim i sipërfaqes së barit nga papastërtite.
- Krehja e sipërfaqes së barit, do të kryhet me një frekuencë 20 herë në vit duke larguar çdo mbetje gjethesh, degesh dhe mbetje nga kositja, me krëhër metalik
- Plehrim i tapetit të barit 4 herë në vit. Ky proces punë kryhet zakonisht pas kositjes së sipërfaqes së barit kryesisht gjatë muajve prill, maj, shtator, nëntor. Produktet plehruese duhet të jenë me shkrirje të ngadalte me përmbajtje azoti, fosfori dhe kaliumi për të përmbushur sa më mirë nevojat agroteknike të tapetit të barit.
- Kositja e sipërfaqes së barit 20 herë në vit me makina korrëse në 90 % të sipërfaqes dhe në 10% me kosa motorrike aty ku është e pamundur të kryhet me makina korrëse.
- Vadtja e tapetit të barit me frekuencë 130 herë në vit.

Vadtja e barit gjatë periudhës së verës, që do të realizohet nëpërmjet tubave të gomës dhe në

vendet ku nuk ka rrjet uji do të kryhet me bote. Duke përdorur 5 l ujë për meter katror.

Kontraktori duhet të kryejë rinovimin e një sipërfaqe prej 20% në vit, sipas kërkesës dhe përcaktimit të Autoritetit Kontraktor.

Shërbimi i rinovimit të hapësirave të gjelberta publike konsiston në:

- Punimi i parë tokës në një thellesi 35-40 cm.
- Shkriftimi dhe thyerje plisash duke bërë pastrimin e gurëve, rrenjëve dhe çdo papastërtie tjetër.
- Sheshim i dheut.
- Punim i dytë 20 cm thellesi duke mbuluar plehun.
- Krehje dhe nivelim.
- Mbjellje e farës së barit.
- Rrulim dhe ngjeshje pas mbjelljes.

7. Mirëmbajtja e barit natyral:

Punimet kryesore për mirëmbajtjen e barit natyral:

- Pastrim i sipërfaqes së barit nga papastërtite.
- Krehja e sipërfaqes së barit, do të kryhet me një frekuencë 12 herë në vit duke larguar çdo mbetje gjethesh, degesh dhe mbetje nga kositja, me krëhër metalik,
- Plehrim i tapetit të barit 2 herë në vit. Ky proces punë kryhet zakonisht pas kositjes së sipërfaqes së barit kryesisht gjatë muajve prill, nëntor.

Produktet plehruese duhet të jenë me shkrirje të ngadalta me përmbajtje azoti, fosfori dhe kaliumi për të përmbushur sa më mirë nevojat agroteknike të tapetit të barit.

- Kositja e sipërfaqes së barit 12 herë në vit me makina korrëse në 90 % të sipërfaqes dhe në 10% me kosa motorrike aty ku është e pamundur të kryhet me makina korrëse.
- Vaditja e tapetit të barit me frekuencë 80 herë në vit.

Vaditja e barit gjatë periudhës së verës, që do të realizohet nëpërmjet tubave të gomës dhe në vendet ku nuk ka rrjet uji do të kryhet me bote. Duke përdorur 5 l ujë për meter katror.

8. Mirëmbajtja e stolave dhe pastrimi i rrugëve dhe terreneve brenda parqeve.

Pastrim i të gjithë sipërfaqes të asfaltuar dhe/ose të këmbësorëve brenda zonës së gjelbëruar ose terreneve brenda parkut duke iu referuar çdo lloj mirëmbajtjeje që përfshin grumbullimin dhe transportimin e çdo lloj mbetjeje të ngurtë (letër, qelq, plastikë, bimësi dhe gjethë të herëpashershme, etj.).

III. Mirëmbajtja e stolave dekorativë

Në pjesën më të madhe të sipërfaqeve të gjelbra, krahas elementëve të tjerë janë vendosur stola dekorativë për relaksim dhe do të bëhet mirëmbajtja e tyre. Këto stola janë të

ndërtuara me konstruksion metalik dhe me ndenjësë dhe mbështetësë druri, Vlerësohet se ato duhet të riparohen çdo vit.

Riparimet përbëhen nga elementë metali dhe druri pasi dëmtohen në kushte të këqija moti, struktura e dërrasës ka nevojë për riparime dhe lyerje me bojë vaji. Gjatë gjithë vitit do të mirëmbahen 216 stola dekorativë

IV. Mirëmbajtja e drurëve dekorativë

Procesi përfshin të gjitha ndërhyrjet e krasitjes që do të kryhen për një dru apo pemë të shëndetshme por edhe për nevojat e aksesueshmërisë, trafikut dhe sigurisë (dukshmëri për pasagjerët, tabela, etj

Shërbimet kryesore në këto drurët dekorativë do të jenë:

- Krasitje e drureve dekorative gjethe mbajtes (proces që do të kryhet 2 herë në vit për mbajtjen e tyre në forma të përshtatshme dekorative)
- Krasitje te drureve gjetherenes + palmat

Procesi përfshin të gjitha ndërhyrjet e krasitjes e cila kryhet në periudhën dhjetor – shkurt, periudhë në të cilën pemët janë në qetësi relative.

- Pleherim
- Vadtje, ky proces duhet të kryhet duke respektuar standartin e harxhimit të 30-50 litër ujë për shkurret dhe drurët dekorative.
- Luftim semundje, është një proces që kryhet gjatë muajve maj-qershor dhe ka për qëllim luftimin e sëmundjeve dhe dëmtuesve për të luftuar insektet e ndryshme për të ruajtur vegjetacionin dekorativ.

5. Mirëmbajtja e shkurreve dekorative

- Punim i shkurreve ky proces ka si qëllim punimin rreth tyre për të eliminuar barërat e këqija dhe shkriftimin e tokës
- Krasitje e shkurreve dekorative, do të kryhet 4 herë në vit duke i dhënë formën e duhur dekorative.
- Pleherim
- Vadtje ky proces duhet të kryhet me bot duke respektuar standartin e harxhimit të 30-litër ujë për shkurre.
- Luftim semundje është një proces që kryhet gjatë muajve maj-qershor dhe ka për qëllim luftimin e sëmundjeve dhe dëmtuesve për të luftuar insektet e ndryshme për të ruajtur vegjetacionin dekorativ.

6. Mirëmbajtja e bordurave të gjelbra

- Punim i shkurreve ky proces ka si qëllim punimin rreth tyre për të eliminuar barërat e këqija dhe shkriftimin e tokës

- Krasitje e bordurave, do të kryhet 8 herë në vit duke i dhënë formën e duhur dekorative.
- Pleherim
- Vaditje ky proces duhet të kryhet me bot duke respektuar standartin e harxhimit të 30-litër ujë për shkurre.
- Luftim semundje është një proces që kryhet gjatë muajve maj-qershor dhe ka për qëllim luftimin e sëmundjeve dhe dëmtuesve për të luftuar insektet e ndryshme për të ruajtur vegjetacionin dekorativ.

Rregulla për tu zbatuar

9. Struktura e ngarkuar për zbatimin e kontrates ka të drejtë të kontrollojë në çdo kohë si gjatë kryerjes së shërbimit dhe pas përfundimit të tij nga Kontraktori.

10. Shërbimi i pastrimit me punëtorë me fshesa të përshtatëshme do të kryhet në të gjithë sipërfaqen e lulishteve duke larguar çdo mbetje dhe papastërti me një frekuencë 2 herë në muaj.

11. Produktet plehruese duhet të jenë me shkrirje të ngadalta me përmbajtje azoti, fosfori dhe kaliumi për të përmbushur sa më mirë nevojat agroteknike të tapetit të barit dhe do të bëhet 4 herë në vit në të gjithë sipërfaqen.

12. Produktet plehruese duhet të jenë të regjistruara dhe të lejuara sipas legjislacionit në fuqi, do të ndalohet përdorimi i produkteve plehruese të paregjistruara; produkteve plehruese me përmbajtje substancash të dëmshme, të cilat mund të përbëjnë rrezik për sigurinë ose shëndetin e njerëzve, kafshëve ose bimëve, ose një rrezik për mjedisin.

13. Kontraktori do të nxitet të implementojë “Praktikat e mira të mbrojtjes së bimëve” ku tërësia e masave dhe e veprimeve për kontrollin e parazitëve me metodat kimike, duke respektuar kushtet në të cilat PMB-të janë regjistruar, si: respektimi i kufijve kritikë, zgjedhja e dozës dhe volumit, koha dhe numri i trajtimeve, mbrojtja e entomofaunës natyrale dhe mjedisit, si dhe kujdesi për shëndetin e përdoruesve e tëkonsumatorëve.

14. Trajtimet me PMB duhet të kryhen me mjete dhe makineri sipas legjislacionit në fuqi për makineritë, që përfshin dhe makineritë për përdorim të PMB-ve, për të garantuar sigurinë e shëndetit të përdoruesve, të mjedisit dhe të bimëve.

15. Kontraktori duhet të kryejë grumbullimin dhe transportimin e të gjitha mbetjeve që rezultojnë nga pastrimi, kositja dhe krasitja në vende të miratuara për depozitim.

16. Për grumbullimin dhe ngarkimin e mbetjeve, do të përdoren kamionçina vetshkarkuese me mbulesa të posaçme për mos lejuar derdhjen e mbetjeve.

3. SHERBIMI I MIREMBAJTJES TE VARREZAVE NE QYTETIN E LEZHES.

Sherbimi që kerkohet :

-Mirmbajtje te siperfaqeve te luleve ne varreza. (pleherim ,vaditje etj)

-Mirembajtje ne siperfaqet e barit te kultivuar ne varreza (kositje, vaditje, pastrime, krehje).

-Punime me bel (I-re dhe II-te) ne siperfaqe te barit te kultivuar siperfaqet e luleve dhe bimesise dekorative shkurre.

-Pastrim dhe kositje e siperfaqeve te barit natyral dhe te kultivuar.

-Krasitje e bimesise dekorative shkurre.

-Pleherim dhe vaditje bari dhe bimesise dekorative.

-Pastrim dhe mirembajtje e sipërfaqeve inerte, rruge e sheshe, sipërfaqe me varre dhe sipërfaqe të lira për varre.

-Mirembajtje e bordurave, ndertesave, rrethimit të varrezave publike dhe deshmorëve etj.

Sherbimi do të realizohet në të gjitha sipërfaqet e varrezave publike në “Gryke Zeze” dhe varrezat publike në “Gocaj”, si dhe në varrezat e “Deshmores” mbështetur në inventarin e elementeve bimorë dhe ndertimore që administrohen nga Bashkia Lezhe.

Nr	Emertimi	Pershkrimi i shërbimit
a.	- Mbjellje dhe shërbime në sipërfaqe të barit të kultivuar	
1-	Punim i parë me bel.	Me këtë shërbim toka punohet në thellesi 20-25cm. Ky punim kryhet duke e përmbytur plisin dhe nxjerrë nga toka të gjithë barerat e keqia, plisi pritët në disa pjesë duke krijuar një mjedis pjësorisht të rrafshët .
2-	Punimi i dytë me bel.	Ky punim kryhet në thellesi 20 cm duke e përmbytur plotësisht dheun që del nga ky punim.Me këtë shërbim largohen të gjitha mbeturinat e ndryshme inerte , bimorë ,si dhe barerat e pa kalbura. Gjate këtij punimi toka nivelohet mirë .
3-	Shpërndarje superfosfati .	Ky proces realizohet pas punimit të dytë të tokës,para sistemit me shatë. Superfosfati hidhet me dorë dhe në mënyrë uniforme në të gjithë sipërfaqen e punuar dhe mbulohet gjatë sistemit me shatë.
4-	Sistemi me shatë.	Gjatë këtij procesi thuhet plisat me diametër të madh, bëhet shkriftimi i dherave dhe nxjerrja e barerave të keqia të mbuluara nga punimi i dytë. Ky shërbim kryhet në thellesi 10 cm. Në përfundim të tij procesi krijohet shtrati për hedhjen e farës së barit.
5-	Hedhja e farës barit.	Pas kryerjes së të gjitha proceseve të punës të cilat kanë të bëjnë me përgatitjen e tokës për mbjellje hidhet fara e barit, procesi punë që kryhet me krah.
6-	Mbulimi i farës barit.	Ky shërbim i cili synon mbulimin e farës së barit me dhe është një procesi punë që kryhet me krah dhe krijon mundësinë e krijimit të kushteve të përshtatshme për mbirjen e farës. Sasia e dheut që mbulon farën nuk duhet të kalojë 2 cm, në të kundërt mbirja vështirohet dhe rrezikon kalbezimin e farës .
7-	Rulimi dhe ngjeshja e tokës	Rulimi i tokës bëhet uniforme duke përdorur një peshe të përshtatshme për këtë qëllim në mënyrë që të mos të ngjeshë shumë tokën për të penguar mbirjen.
8-	Vaditja e sipërfaqes së barit.	Ky proces kryhet në të gjitha rastet kur thatësira vështireson zhvillimin e embrionit të farës, për këtë arsye kryhet një vaditje e lehtë në formë shiu .
9-	Nitrifikimi	Nitrifikimi i sipërfaqeve të mbjella me barë kryhet me dorë të lirë në të gjithë sipërfaqen në mënyrë të njëtrajtshme, kujdes i veçantë duhet treguar në zonat e barit ku ngjyra e barit është e zbehtë .
10-	Krehja e sipërfaqeve të barit.	Ky proces kryhet për të mbajtur të pastër sipërfaqen e barit dhe për të krijuar kushte të përshtatshme për rritjen dhe zhvillimin e barit.Eshtë një proces që ndihmon në rritjen e fuqisë së bimes për vllazërim.
11-	Pastrimi i sipërfaqeve të barit.	Ky është një procesi punë i cili kryhet çdo ditë për të krijuar tapete të pastërta nga mbeturinat e ndryshme .
12-	Heqja e barerave të keqia me bajonete.	Ky proces kryhet sa herë konstatohen barera të keqia në sipërfaqen e tapetit, por duhet kryer me shunë kujdes për të mos demtuar barin e mbjellë dhe moskrijimin e vatrave të lira nga barë.
13-	Kositja.	Kositja bëhet me makine kositore bari, çdo 20-25 ditë kryesisht në periudhën e pranverës dhe verës kur rritja e barit është në mënyrë intensive.Kositja duhet bërë me rrjeshta të drejta duke krijuar një sfond të rregullt të tapetit të barit.
b.	Sherbime në sipërfaqe të barit natyral	
1-	Pastrimi dhe largimi i mbeturinave me krah dhe mjete të mekanizuara.	Një nga proceset e punës për mirembajtjen e barit natyral është edhe pastrimi nga mbetjet e ndryshme bimorë, urbane, inerte etj. Ky shërbim është i përditshëm dhe kryhet me dorë ose me rreshqel. Mbeturinat e grumbulluara largohen me mjete të ndryshme si korroca dhe mjete transporti në pikat e grumbullimit të përcaktuara për këtë qëllim. Me këtë duhet të kuptojmë se në sipërfaqet e barit natyral vazhdimisht krijohen mbeturina inerte nga hapja dhe mbyllja e varreve.

2-	Kositja e barit.	Kositja e barit kryhet me motorrkorrese cdo 20-25 dite sidomos gjate periudhes se pranveres dhe veres dhe grumbullohet ne nje cep per tu transportuar, pas kositjes kryhet krehja e barit per te ktijuar nje tapet te paster dhe te sistemuar
c. <i>Sherbime ne shkurre dekorative</i>		
1-	Punim i pare	Ky punim behet me bel ,ne thellesi 20-25 cm nga muaj dhjetor . Ky punim ka per qellim te permbysh plisin e dala nga vera i cili eshte i ngjeshur dhe i mbushur me infeksione dhe barer ate keqia .
2-	Punimi i dyte	Punimi i dyte me bel realizohet ne fillimet e pranveres pasi mjedisi i punuar me bel ka qendruar i fjetur per dy-tre muaj. Ky punim ka per qellim nxjerrjen e barerave te keqia si dhe sistemimin e tokes rreth bimes .
3-	Prashitje e pare	Ky sherbim behet pas punimit te dyte te tokes dhe ka per qellim sistemimin e tokes dhe mbylljen e hapesirave te krijuara nga punimi i dyte si dhe krijimin e porozitetit (kapilaritetit) te nevojshem per kryerjen e proceseve fiziologjike te sistemit rrenjore .
4-	Prashitja e dyte	Prashitja e dyte ka si objekt me shume prerjen e barerave te keqija per mbrojtjen e kapilaritetit te tokes, mbrojtjen e bimes nga thatesira dhe krijimin e nje mjedisi te kulturuar. Ky process kryhet nga fundi pranveres para fillimit te temperaturave te larta te veres.
5-	Krasitja e shkurreve dekorative .	Krasitja e shkurreve dekorative behet me kujdes nga nje specialist i kualifikuar ,ky sherbim kryhet ne periudhen e vjeshtes dhe te dimrit. Ky sherbim ka si qellim heqjen e degeve te teperta si dhe ato te thara duke krijuar nje kurore te pershtateshme .krasitja behet gjithnje ne kohe te mire, pa lageshtire dhe ngrica dhe orari me i pershtateshem eshte nga ora 10:00-14:00.
6-	Krasitje formuese	Krasitja formuese realizohet ne menyre periodike cdo 20 - 25 dite, duke filluar nga muaj maji e ne vazhdim. Ky sherbim ka si qellim krijimin e kurores dekorative, duke i dhene asaj formen e parashikuar ne mozaikun e bimeve te mjedisit te gjelbert.
7-	Vaditja	Ky process realizohet kryesisht gjate periudhes se muajve te veres dhe vaditja behet kryesisht ne forme shiu .Vaditja rekomandohet te kryhet ne oret e para te mengjesit dhe pasdite vone por jo ne pikun e temperatuarve te larta te dites.
d. <i>Mbjellja dhe sherbimet ne siperfaqet e luleve</i>		
1-	Punimi i pare	Me kete sherbim toka punohet ne thellesi 20 -25cm.Ky punim kryhet duke e permbysur plisin dhe nxjerre nga toka te gjitha barerat e keqia, plisi pritjet ne disa pjese duke krijuar nje mjedis pjesisht te rrafshet
2-	Punimi i dyte	Ky punim kryhet ne thellesi 20 cm duke e permbysur plotesisht dheun qe del nga ky punim.Me kete sherbim largohen te gjitha mbeturinat e ndryshme inerte, bimore si dhe barerat e pa kalbura. Gjate ketij punimi toka nivelohet mire.
3-	Hedhje superfosfati	Ky process realizohet pas punimit te dyte te tokes, para sistemimit me shate. Superfosfati hidhet me dore dhe ne menyre uniforme net e gjithë siperfaqen e punuar dhe mbulohet gjate sistemimit me shate.
4-	Nivelim	Gjate ketij procesi thuhet plisat me diameter te madh, behet shkriftimi i dherave dhe nxjerrja e barerave te keqia te mbuluara nga punimi i dyte. Ky sherbim kryhet ne thellesi 10 cm. Ne perfundim te tij procesi krijohet shtrati per hedhjen e fares.
5-	Mbjellja	Pas kryerjes se te gjitha proceseve te punes te cilat kane te bejne me pregatitjen e tokes per mbjellje hidhet fara, process pune qe kryhet me krah.
6-	Pleherim	Pleherimi i siperfaqeve te mbjella me lule kryhet me dore te lire ne te gjithë siperfaqen ne menyre te njetrateshme.
7-	Vaditje	Ky proces kryhet ne te gjitha rastet kur thatesira veshtireson zhvillimin e embrionit te fares, per kete arsye kryhet nje vaditje e lehte ne forme shiu pas mbjelljes dhe pastaj sa here eshte e nevojshme.
e. <i>Sherbime ne drure dekorative</i>		
1-	Punim me bel	Ky punim behet me bel ,ne thellesi 20-25 cm nga muaj dhjetor . Ky punim ka per qellim te permbysh plisin e dala nga vera i cili eshte i ngjeshur dhe i mbushur me infeksione dhe barer ate keqia .
2-	Krasitje	Krasitja e drureve decorative behet me kujdes nga nje specialist i kualifikuar ,ky sherbim kryhet ne periudhen e dimrit. Ky sherbim ka si qellim heqjen e degeve te teperta si dhe ato te thara duke krijuar nje kurore te pershtateshme .krasitja behet gjithnje ne kohe temire ,pa lageshtire dhe ngrica .

3-	Pleherim	Pleherimi behet kryesisht ne periudhen e pranveres me nitrat pasi te jete bere me pare punimi me bel .
4-	Vaditja	Vaditja behet gjate periudhes se veres kur si rezultat I temperaturave te larta ndjehet mungesa e lageshtires, vaditja zakonisht kryhet me tub gome .
f.	<i>Sherbimet ne gardhet e gjelberta</i>	
1-	Punimi me bel	Ky punim behet me bel ,ne thellesi deri ne 20 cm ne pranvere dhe ne vjeshte . Ky punim ka per qellim te permbysh plisin cili eshte i ngjeshur dhe i mbushur me infeksione dhe barer ate keqia .
2-	Krasitje	Krasitja e gardheve te gjelberta behet me kujdes nga nje specialist i kualifikuar ,ky sherbim kryhet disa here gjate vitit kryesisht gjate periudhes se vegjetacionit te bimeve dhe ka si qellim dhenjen e formes se duhur ketyre gardheve te gjelberta .
3-	Pleherim	Pleherimi i siperfaqeve te gardheve te gjelberta kryhet me dore te lire ne te gjithë siperfaqen ne menyre te njetrajtshme dy here gjate vitit .
4-	Vaditje	Vaditja behet gjate periudhes se veres kur si rezultat i temperaturave te larta ndjehet mungesa e lageshtires ,vaditja zakonisht kryhet me tub gome .
g.	<i>Sherbime ne siperfaqe inerte dhe rruge e sheshe si dhe siperfaqe me varreza dhe te lire per varre</i>	
1-	Pastrimi i siperfaqeve	Ky sherbim behet per pastrimin e siperfaqeve inerte nga mbeturinat e ndryeshme urbane, inerte, bimore, etj...
2-	Mirmbajtja e bordurave dhe varreve prej mermeri	Pastrimi i siperfaqeve me uje behet disa here gjate vitit ne menyre qe keto objekte te jene vazhdimisht ne gjendje te mire.
3-	Mirmbajtje e ndertesave te sherbimit dhe rrethimi i varrezave	Mirmbajtja e ambjenteve te ndertesave si tek varrezat publike ashtu edhe te deshmoreve duhet te jete ne nivelin e prezantimit me culture ne syrin e qytetareve qe vijne ne keto objekte. Lyerja e ndertesave, merimetimi i tyre, dyer dhe dritare si dhe elemente te tjere ndertimi te kihet parasysh sebashku me mirmbajtjen e rrethimit dhe lyerjen me boje te tyre minimalisht dy here ne vit.

Shtojca 9

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 10.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimi nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

➤ Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

➤ Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10.*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Kjo pikë e kriterëve plotësohet me Kriteret e përgjithshme të pranimi/ vecanta te kualifikimit të plotësuar më sipër. (Shtojcat).

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024 dhe 2025, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit objekt prokurimi.

2.2.2 Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin një dokument që vërteton se subjekti i ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë dokument.

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik të formularit permbledhes të vetedeklarimit sipas shtojcës perkatese të DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afatëve të ankimimit.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatorët Ekonomik duhet të paraqesin dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Këto furnizime të ngjashme duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a-Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me institucione shtetërore, Operatorët Ekonomik duhet të paraqesin vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

ose

b-Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

2.3.2 Operatorët Ekonomikë duhet të jete i pajisur me license Kategoria II.4 me emertim veprimtarie "Tregtim farave dhe fidaneve". Për të përmbushur këtë kriter duhet të paraqesin licensën perkatese.

2.3.3 Operatorët Ekonomikë ofertues duhet të kete të punësuar të paktën 18 (tetëmbëdhjetë) punonjës për periudhën Maj 2026 – Qershor 2026, të vërtetuar me:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën Maj 2026 – Qershor 2026.
- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Maj 2026 – Qershor 2026

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik të formularit permbledhes të vetedeklarimit sipas shtojcës perkatese të DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afatëve të ankimimit.

2.3.4 Operatoret Ekonomike ofertues duhet te disponojne ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi mjetet e meposhteme:

- 1 (nje) Automjet me kapacitet transportues deri ne 3.5 ton.
- 1 (nje) Autobot me kapacitet jo më të vogel se 10,000 lit, për vaditjen e drurëve dekorativ.
- 1 (nje) Autovinç me kosh per krasitje,
- 2 (dy) Makinë korrse,
- 2 (dy) Kosa motorrike,
- 1 (nje) Pompe për spërkatje
- 1 (nje) Fryrese/Aspirator Gjethesh
- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur jane ne pronesi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vertetojne pronesine e mjetit: -leja e qarkullimit; -çertifikaten e kontrollit teknik; - siguracionin; - taksat vjetore, si dhe të paraqesë foto të qarte për secilin mjet dhe te jetë e dukshme targa e mjetit.
- Ndersa per mjete te marra me qera/kontrate bashkepunimi krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qerases/ bashkëpunimit.
- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur jane ne pronesi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimit, fotot dhe fatura tatimore perkatese, ndersa per mjete te marra me qera/ Kontrate bashkëpunimi, krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qeras/ Kontrate Bashkepunimi.

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatoret ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimit.

2.3.5 Operatoret Ekonomike ofertues duhet të jetë i Çertifikuar sipas standarteve ISO te leshuara nga organizmat e vleresimit te konformitetit te cilat jane te akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise, konkretisht:

- **ISO 9001:2015**, mbi “Sistemin e menaxhimit të cilësisë”, ose ekuivalentin e saj
- **ISO 14001:2015**, mbi “ Sistemin e Manaxhimit Mjedisor ”, ose ekuivalentin e saj

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 10.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik
_____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	-----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- **Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

• Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

etj.

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

Sqarime _____ nëse _____ vlerësohet _____ e
nevojshme _____

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Në cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, Deklaroj Se:

Jam në dijeni të pasojave që vinë ndaj meje lidhur me këtë Deklaratë, në respektim të ligjit nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Kam përgatitur ofertën në mënyrë të pavarur, pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër⁷.

Në veçanti, pa kufizuar si më lart, nuk kam pasur kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent me qëllim cënimin e konkurrencën, në lidhje me:

çmimet;

metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;

qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,

paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

Nuk kam pasur marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent, me qëllim cënimin e konkurrencës, në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë.

